

MARREVESHJE DHE RAPORT NE LIDHJE ME BASHKIMIN ME PERTHITHJE

TIRANE, ME 15.06.2021

NDERMJET

BONUM Shpk.

(si shoqeria perthithese)

Dhe

CDF Shpk.

(si shoqeria e perthithur)

TABELA E PERMBAJTJES

I.	HYRJE.....	2
II.	BASHKIMI ME PERTHITHJE	3
III.	BILANCI I HAPJES DHE I MBYLLJES	3
IV.	AKTIVET E TRANSFERUARA.....	3
V.	MBYLLJA	4
VI.	KUOTAT	4
VII.	SHOQERIA, PERPARESITE E VECANTA DHE PERFITIMET	4
VIII.	MBROJTJA E KREDITOREVE.....	4
IX.	TE NDRYSHME	4
X.	PASOJAT PER TE PUNESUARIT	5
XI.	ZGJIDHJA E MARREVESHJES.....	5
XII.	LIGJI I ZBATUESHEM.....	5
	Tirane, me	5

I. HYRJE

BONUM Shpk, është shoqëri e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) L42419006N, me seli në adresën: Godine 1 kateshe tek Kodra e Bakalleve, Yrshek, Kashar, Tirane, Shqipëri, e cila ka objekt veprimtarie si vijon:

- Kultivim, prodhim, përpunim, ambalazhim, tregtim me shumicë e pakice produktesh bujqësore dhe blegtorale. Mbarëshitme bagetish të imta. Për përmbushjen e objektit, shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër të natyrës financiare e tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tregtar, operacione që lidhen me pasuritë a luajtshme dhe të paluajtshme, si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndermarrje, dege ndermarrjesh, si edhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsociume, të themeluara apo në themelimin e siper, që kanë objekt të njëjtit ose të ngjashëm me të vetin apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë, si dhe të japë garanci, dorezani, të marrë hua dhe ofrojë garanci, pasurore apo personale, në favor të të tjerëve. Të japë konsulence menaxheriale dhe financiare dhe këshillime të tjera. Me në përgjithësi, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Kapitali themeltar i shoqërisë ka vlerën e 196.100,00 Euro.

Ortaket e BONUM Shpk. janë:

- Z. Indrit Reso zotëruar i 10% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - Z. Ilir Dervishi zotëruar i 10% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - INTEGRIS Shpk zotëruar i 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - AMERICAN CAPITAL Shpk zotëruar i 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
-
- **CDF Shpk**, shoqëri e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) L61612012F, me seli në adresën: Kodra e Bakalleve, Rruga Tafarim Bakalli, Godine 2-kateshe, Zona Kadastrale 3865, Nr. Pasurie 125, 58/12, 125/6, 126/4, 125/5, Kashar, Tirane, Shqipëri, e cila ka objekt veprimtarie: Përpunimin, ambalazhinim, konservimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale me teknologji moderne. Shoqëria mund të kryejë operacione tregtare me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të administrojë, të blejë, të shesë, të japë me qira si dhe të ketë interesa e pjesëmarrje në shoqëri, konsociume të themeluara apo në themelimin e siper, që kanë objekt të ngjashëm me objektin e aktivitetit të shoqërisë, ose që i shërben realizimit të këtij objekti. Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

Kapitali themeltar i shoqërisë ka vlerën e 30.000,00 Euro.

Ortak i vetëm i CDF Shpk. është **BONUM Shpk**, një shoqëri e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) L42419006N, me seli në adresën: Yrshek Godine 2 kateshe tek Kodra e Bakalleve, Yrshek, Kashar, Tirane, Shqipëri, zotëruarë e 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Shoqeria CDF ShPK. bashkohet nga ana ligjore dhe organizative me shoqerine BONUM Shpk. Ne kete menyre BONUM Shpk. dhe CDF Shpk. integrohen ne nje person juridik te vetem (“**Transaksioni i Bashkimit**”), ku BONUM Shpk. eshte shoqeria perthithese dhe CDF Shpk., ajo e perthithur.

Qellimi i Bashkimit eshte perqendrimi i forcave dhe mjeteve per realizimin e objektit te CDF Shpk ne funksion te rritjes se aktivitetit dhe fitimit.

II. BASHKIMI ME PERTHITHJE

Ne kete operacion bashkimi shoqeria BONUM Shpk. do te jete shoqeria perthithese e shenuar ne vijim si shoqeria perfituese e kontributeve, kurse shoqeria CDF Shpk. do te jete shoqeria e perthithur.

Ne kuadrin e ketij procesi, sikurse bazuar ne Nenin 215, paragrafi 1 te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” i ndryshuar (“Ligji 9901”), shoqeria CDF Shpk. do te transferoje me ane te Bashkimit me Perthithje te gjitha aktivet dhe pasivet qe zoteron sipas dokumentacionit financiar te deritanishem.

Ne perputhje me Nenin 220, paragrafi 2, pika c, te Ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, shoqeria e perthithur CDF Shpk. do te vleresohet e prishur dhe shoqeria perthithese BONUM Shpk. do te vazhdoje te ekzistojte me te njejtin objekt te aktivitetit dhe do te drejtohet nga administratori i Bonum Shpk, z.Dervis Kanina.

III. BILANCI

Perthithja do te kryhet ne daten e regjistrimit te Mbylljes se Bashkimit me Perthithje ne Regjistrin Tregtar (“**Regjistri Tregtar**”) prane Qendres Kombetare te Biznesit,.

Ne aspektin e kontabilitetit, te dyja shoqerite do te vazhdojne te regjistrojne te gjitha operacionet e veprimtarise te kryera prej tyre deri ne daten e realizimit te bashkimit te kontabilizuara veç e veç.

Bilancet e Hapjes se Bashkimit me Perthithje do t’i bashkengjitet kesaj Marreveshje te Bashkimit me Perthithje.

IV. AKTIVET E TRANSFERUARA

Ne perputhje me Nenin 215, paragrafi 1 te Ligjit 9901, CDF Shpk. transferon si pasoje e Bashkimit me Perthithje, te gjitha aktivet e qendrushme materiale dhe jo materiale, te paraqitura ne formen e aktiveve dhe pasiveve, duke perfshire marredheniet kontraktore dhe marredhenie te tjera juridike si dhe qendrimet ligjore te çdo lloji, te arketueshmet dhe detyrime, detyrime potenciale, te arketueshmet te ardhshme (“Aktivet dhe Pasivet e Transferuara”).

BONUM Shpk. merr ne posedim te gjithe librat, korrespondencen, te dhenat operative dhe regjistrime te tjera te mbajtura nga CDF Shpk. Gjithashtu BONUM Shpk. merr ne posedim te gjitha instrumentet e nevojshem per te provuar ekzistencen e te drejtave qe do te transferohen tek ai. BONUM Shpk. do te ruaje te gjithe librat, korrespondencen, te dhenat operative dhe regjistrime te tjera tregtare per CDF Shpk. gjate gjithe periudhes ligjore te ruajtjes se tyre.

BONUM Shpk. do te regjistroje prane Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme çdo te drejte pronesia (nese ka) qe transferohet nga CDF Shpk. drejt BONUM Shpk. si pasoje e Perthithjes, ne perputhje me ligjin e zbatueshem dhe me aktet nenligjore perkatese.

V. MBYLLJA

Me qellim Mbylljen, palet do te bejne te mundur qe dokumentet e meposhtem te pergatiten, nenshkruhen dhe dorezohen:

- i. Marreveshjen Perfundimtare te Bashkimit me Perthithje;
- ii. Nje kopje e Vendimit te Ortakeve te BONUM Shpk. dhe CDF Shpk. gjate se ciles miratohen Marreveshja Perfundimtare dhe perfundimi i Bashkimit me Perthithje.

VI. KUOTAT

Shoqeria BONUM Shpk. do te jete zoteruese e kapitalit te shoqerise CDF Shpk. ne daten e realizimit perfundimtar te marreveshjes.

Kapitali i shoqerise pas bashkimit me perthithje do te jete ne vleren totale te bashkimit te kapitalit te dy shoqerive, prej **226,100,00 Euro**, e ndare sipas kuotave:

- Z. Indrit Reso zoterues i 10% te kapitalit themeltar te shoqerise, vlera e kapitalit 22,610 Euro;
- Z. Ilir Dervishi zoterues i 10% te kapitalit themeltar te shoqerise, vlera e kapitalit 22,610 Euro;
- INTEGRIS Shpk zoterues i 30% te kapitalit themeltar te shoqerise, vlera e kapitalit 67,830 Euro;
- AMERICAN CAPITAL Shpk zoterues i 50% te kapitalit themeltar te shoqerise, vlera e kapitalit 113,050 Euro.

VII. SHOQERIA, PERPARESITE E VECANTA DHE PERFITIMET

Ky operacion bashkimi nuk do te permbaje as te drejta dhe as ndonje avantazh te veçante.

VIII. MBROJTJA E KREDITOREVE

Kreditorët e BONUM Shpk. dhe CDF Shpk. mbrohen ne perputhje me nenin 221 te Ligjit 9901 i ndryshuar.

IX. TE NDRYSHME

Kjo Marreveshje (bashke me dokumentet bashkangjitur saj) perben Marreveshjen ne teresi dhe Marreveshjen mes Paleve, zevendeson dhe ka perparesi ndaj çdo Marreveshje, rregullimi apo veprim te meparshem te Paleve ne lidhje me kete çeshtje.

Çdo ndryshim i kesaj Marreveshje do te jete i vlefshem vetem nese eshte bere me shkrim dhe eshte nenshkruar nga Palet.

Ne rast se nje pjese e kesaj Marreveshjeje eshte /ose shpallet e pavlefshme ose jo detyruese, pjesa tjeter mbetet e vlefshme dhe detyruese per Palet. Ne kete rast, Palet zevendesojne dispozitat e pavlefshme ose jo detyruese me dispozita te vlefshme dhe detyruese, efekti i te cilave, per aq sa eshte e mundur, eshte sa me i afert me dispozitat e pavlefshme ose jo detyruese duke pasur parasysh permbajtjen dhe qellimin e kesaj Marreveshjeje.

X. PASOJAT PER TE PUNESUARIT

Duke marre parasysh se aktualisht CDF Shpk. nuk ka asnje punemarres atehere nuk parashikohet asnje pasoje mbi punemarresit e CDF Shpk.

Duke marre parasysh se BONUM Shpk., do te jete ne cilesine e shoqerise perthithese nuk parashikohet asnje pasoje mbi punemarresit e BONUM Shpk.

XI. ZGJIDHJA E MARREVEESHJES

Kjo marreveshje mund te zgjidhet ne çdo kohe perpara Dates se Mbylljes me miratimin e dhene me shkrim nga te dyja Palet.

XII. LIGJI I ZBATUESHEM

Kjo marreveshje do rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve dhe akteve te tjere me fuqine e ligjit te zbatueshme ne Republiken e Shqiperise dhe veçanerisht nga nenet 215-226, te ligjit nr. 9901 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, date 14.04.2008 dhe Ligji nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" i ndryshuar.

Tirane, me 15.06.2021

Shoqeria BONUM Shpk.

Administratori

Shoqeria CDF Shpk.

Administratori

